



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
Nr./Br. 1108/1112/20  
Data/Datum. 25.01.2021  
PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.1108/20  
1112/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtuar nga operatori ekonomik “BOTEK” SHPK-Prishtinë, si dhe OE “N.T.SH. ARTECH” dhe “N.T.P ERAMED”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “ARITECH” SHPK & “CIMI@ELECTRONIC” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”, më datën: 22.01.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “BOTEK” SHPK-Prishtinë, kurse aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “N.T.SH. ARTECH” dhe “N.T.P ERAMED”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “BOTEK” SHPK-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, kurse ankesa e OE “N.T.SH. ARTECH” dhe “N.T.P ERAMED”-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “BOTEK” SHPK-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 17.12.2020 me nr. 1108/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 20 të RRUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues “N.T.SH. ARTECH” dhe “N.T.P ERAMED”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.12.2020 me nr. 1112/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 28, 59, 72, 99 dhe 105 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41.3, 49.25, 49.26 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 29.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në

dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit të OE ankues **“Artech NTSH & Eramed NTP”** ku thuhet që AK ka vepruar kundërligjshëm duke shpallur njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin shpall fitues GOE“ARITECH Sh.P.K; CIMI ELECTRONIC Sh.P.K dhe i ka eliminuar OE ankues **“Artech NTSH & Eramed NTP”** me arsyetimin se nuk kanë dorëzuar katalogun e njëjte me të cilin kanë ofertuar në dosjen e tenderit, Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar pretendimin në fjalë, andaj konform nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si çështje e gjykuar “res judicata”. Konstatimi mbi pretendimin e lartpërmendur është dhënë në raportin me numër rendor 683/20.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues **“Artech NTSH & Eramed NTP”** ku thuhet që AK gjithashtu ka vepruar kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 të LPPsë dhe nenin 49.25 dhe 49.26, pasi që ky i fundit dështuar të verifikoj kushtet formale të dokumenteve të tenderit pasi që ka pranuar dokumentin me nr. Referencë 1038ERQ ISO 9001:2015, Quality Management System në emër të CIMI ELECTRONIC Sh.P.K si jo të rregullt dhe sipas verifikimit dhe vlerësimit tonë janë të falsifikuara, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe shkresave të dërguara nga palët e përfshira, gjen pretendimin si të pabazuar duke argumentuar si në vijim:

- Në letrën standarde për sqarim të dosjes së tenderit dërguar OE të rekomanduar nga Autoriteti Kontraktues, OE i rekomanduar ka bashkëngjitur certifikatën e lartpërmendur duke vërtetuar kështu validitetin e një certifikate të tillë deri me 01.07.2021. Falsifikimi i një dokumenti të tillë mbi bazën e ndërhyrjeve teknike dhe nënshkrimit të personit të autorizuar nuk mund të evidentohet nga Eksperti Shqyrtues dhe nuk është nën përgjegjësinë juridike dhe as teknike që një vërtetim i tillë të konstatohet nga ky i fundit. Certifikata e bashkëngjitur (shih më poshtë) është konform fushëveprimit të kërkuar dhe si e tillë është valide në afat kohor të përcaktuar.



# Certificate

## Quality Management System



Certificate No: 1038EQ

For: Cini @ ELECTRONIC SRLPK

Address: Rr. Azem Bejta, Skenderaj, Prishtine

Assessment Scope: Supply, installation of security system equipment, camera, electrical systems, automatic systems

International standard: ISO 9001:2015, Quality Management System

Issue: 01, Certification date: 02 July 2020  
Date of issue of the certificate: 02.07.2020  
Date of validity of the certificate: 01.07.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 02.06.2020.  
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.  
The certificate will be extended for one year.  
Recertification audit before date of first issuance

Website: Online: [www.ebsgmbh.com/QTUV/1038Q](http://www.ebsgmbh.com/QTUV/1038Q)  
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion  
Und Validierung, Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany  
Email: [validity@ebsgmbh.com](mailto:validity@ebsgmbh.com)

Exzellente Bewertungssysteme

QMS ISO 9001:2015

Authorized Signature

International Communications and cooperation office:  
EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion  
Und Validierung  
Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany  
[www.ebsgmbh.com](http://www.ebsgmbh.com)

\*Document model in English language, Page: 1-1

Sa i përket pretendimin ankimor të OE ankues **"BOTEK SHPK"** ku thuhet që AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe UOPP-së pasi ka shpërblyer me kontratë një grup të OE të papërgjegjshëm teknikisht pasi që këta të fundit kanë ofertuar me pajisjen HP e cila nuk përmbushë kërkesën minimale të vendosur në Aneksin 1 të DT-së, gjegjësisht konfigurimin e kombinuar për Drives; SSD: 500 GB dhe HDD: 500 GB si dhe Lexuesi optik: DVD Drive pasi që në broshurën e dorëzuar nga vete OE i rekomanduar "Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor" konkretisht në faqen 2 të broshurës shkruan qartësisht "KUJDES" si në vijim: Note: Folloëing configurations are supported: a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive, b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive, c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage, Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar pretendimin në fjalë, andaj konform nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si çështje e gjykuar "res judicata". Konstatimi mbi pretendimin e lartpërmendur është dhënë në raportin me numër rendor 661/20.

Sa i përket pretendimin ankimor të OE ankues **"BOTEK SHPK"** ku thuhet që në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë të datës 13.04.2020, është qartësuar nga ana e AK- së se operatorët ekonomikë duhet të ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë specifikat teknike si tek pjesa e "Pretendimeve Ankimore" e këtij raporti, ku OE ankues thotë që për këtë pozicion, OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk, në ofertën e tyre NUK ka dorëzuar fare Broshurën për mbajtësin e TV si dhe NUK ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e mbajtësit të TV, Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar pretendimin në fjalë, andaj konform nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si çështje e gjykuar "res judicata". Konstatimi mbi pretendimin e lartpërmendur është dhënë në raportin me numër rendor 661/20.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues i sheh ankesat e operatorëve ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore" me nr. të prokurimit: "616-20-1154-1-1-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Prishtinë, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues duhet të jenë: pjesërisht të bazuara dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues me datë 30.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

AK nuk pajtohet fare me ekspertizën e aq me tepër qeshtja për te cilën është vendosur me vendim dhe faktet e prezantuara fare nuk janë shqyrtuar në ekspertizë me çka bien ndesh me parimin e çmuarjes së lire të provave dhe vlerësimit të provave.

Ju lutem referojuni provave të bashkangjitura në vendime të Autoritetit Kontraktues pasi qeshtja duhet të gjykohej në baze të provave dhe dëshmive.

Operatori ekonomik "Botek SHPK" – Prishtinë, me datë 04.01.2021 anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në konfirmojmë pranimin e mendimit të ekspertit shqyrtues nr. 1108/20 dhe njëkohësisht shprehim mospajtimin tonë me konstatimet e tij "res judicata" duke mos i trajtuar me kujdes fare provat teknike të patejkalueshme të ankesës, derisa pajtohemi me mendimin përmbljedhës dhe propozimin e tij që lënda të kthehet në Rivlerësim.



Konstatimet jo të sakta të ekspertit shqyrtues ne ekspertizën i tij fillestare, sipas të gjitha gjasave vijnë për shkak edhe të mungesës së njohurive teknike dhe interpretimit jo adekuatë të fakteve teknike. Prandaj, bashkangjitur e gjeni mospajtimin / parashtrësën tonë ne këtë ekspertizë duke i zbërthye edhe një herë fakte teknike profesionale të cilat ne fakt kanë qenë dhe janë në ankesën tonë.

Me këtë rast ftojme Ekspertin shqyrtues të kësaj lëndës ti Rishqyrtoj edhe njëherë pikat teknike dhe në seancën e panelit shqyrtues apo kontaktoj Prodhuesin HP dhe të paraqes faktet mbi të cilat kjo ankesë është e bazuar në plotni.

Ftojme Panelin shqyrtues të OSHP që ti marrë për bazë PROVAT e prezantuara ne Ankesën tonë duke angazhuar një Ekspert teknik për trajtimin e tyre profesional, që mënyrë që të mund të merr një vendimi meritore për këtë lëndë.

Të nderuar anëtar të panelit shqyrtues të OSHP-së,

I nderuari z. Dior Halili, Ekspert Shqyrtues,

Ne konstatojmë me keqardhje se edhe në këtë Ekspertizë janë bërë lëshime teknike / keqinterpretime teknike, të cilat nuk do donim të kishin ndodhur dhe në fakt nuk do duhej të ndodhnin as në ekspertizën e parë e përkundër fakteve të patejkalueshme. Ne procedurën e Re të Ankesës Eksperti Shqyrtues, as që merr mundin që ti analizoj Faktet por vijon me shprehjen "res judicata" duke anashkaluar Faktet, LPP dhe Rregulloren ne fuqi.

Në vijim po i Ri konfirmojmë / sqarojmë pikat të cilat eksperti shqyrtues për mungesë të ekspertizës teknike edhe mund t'i kenë ikur pa i vërejtur apo nuk ka arriturt'i interpretoj teknikisht me saktësi.

**PIKA 1. Sqarim:** Për pozicionin 2 ne DT. KOMPJUTER Brand Name -Mid Toëer, në DT është kërkuar që kjo pajisje të ofrohet me 3x komponentë - për 2X Storage and 1x Drives (SSD, HDD dhe Lexuesi Optik) Ndërsa për këtë pozicion OE "Aritech & Cimi@Electronic shpk " kanë ofertuar Pajisjen HP Desktop Pro 300 G3 e cila nuk ka mundësi nga vetë prodhuesi të ofrohet me 3x komponente për Storage and Drives siç është kërkuar në DT por kjo pajisje ka mundësi të ofrohet vetëm me 2x komponente për Storage and Drives ku klienti mund të zgjedhë sipas nevojës se cilat komponentë mund të kombinoj.

Në ekspertizën tuaj fillestare ju si ekspert shqyrtues nuk e keni marr për bazë fare faktin apo e keni keqkuptuar qëllimisht. që kjo pajisje kërkohet të ofrohet me 3 x komponentë, (pra 2X Storage and 1X Drives) dhe nuk i keni marr për bazë fare faktet që kjo pajisje nga prodhuesi HP ofrohet vetëm me 2x komponente.

Pra, Modeli i Pajisjes HP (Kompjuter HP Desktop Pro G3) i ofertuar nga OE Aritech & Cimi@Electronic shpk, duke u bazuar në Broshurat e prodhuesit, NUK ka mundësi konfigurimi sikurse është kërkuar kombinim i 3X komponente për storage and drives: SSD, HDD dhe Lexuesi Optik dhe këtui s'ka asnjë dilemë pasi që qartësisht dhe përtej çfarëdo keqinterpretimi po në këtë broshurë shkruan qartë:

**Prova 1:** Për ta vërtetuar këtë fakt, ju lutem e gjeni të bashkangjitur broshurën e dorëzuar nga vete OE, "Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor" konkretisht ne faqen 2 të broshurës ku shkruan qartësisht "KUJDES"

si ne vijim se kjo Pajisje lejon/suporton vetëm këto kombinime:

**Note:** Following configurations are supported:

- a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive
- b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive
- c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage
- d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage

Edhe një herë po Rikonfirmojm se ne nuk kemi interpretua asgjë përtej fakteve dhe e lusim ekspertin shqyrtues apo Panelin Shqyrtues, që duke konsultuar edhe persona teknik profesional si dhe dokumentacionin e tenderit apo duke kontaktua edhe vete prodhuesin HP, ta Rishikoj me kujdes **Botek** ■ Rruga, Agim Ramadani, Nr.517, Aktash 1,10 000 Prishtinë

**Tel:** +381 38 245 830 / 840 ■ **Fax:** +381 38 245 625 ■ **Email:** info@bo-tek.com ■ **Web:** www.bo-tek.com

Interpretimin e pabazuar të ekspertit shqyrtues, pasi që këtu s'ka asnjë dilemë dhe se vet Prodhuesi thërret në shprehjen "Note" apo "Kujdes" dhe këtë PROVË e cila gjendet ne Broshurën e prodhuesit HP të cilën Broshurë këta OE e kanë dorëzuar me tender. Rrjedhimisht, përtej çfarëdo dileme kjo pajisje e ofertuar, NUK i përmbushë kërkesën teknike sipas dosjes së tenderit dhe oferta teknike e OE "Aritech & Cimi@Electronic shpk" është teknikisht e papërgjegjshme dhe si e tillë do duhej të refuzohej.

PIKA 2. Ne shprehim mospajtimin tonë me konstatimin e Ekspertit se "Sgarimet shtesë NUK qenkan bazë për Vlerësim e tenderit" dhe shprehim mospajtimin tonë me qëndrimin e ekspertit i cili edhe këtë pikë e trajton si "res judicata" duke i anashkuar trajtimin e tyre profesional dhe fakteve të patejkalueshme të cilat mbështeten në Dosjen e Tenderit, LPP dhe Rregulloret ne fuqi.

Ne besojmë se OSHP do ta qartëson përtej çfarëdo dileme se sqarimet shtesë janë pjesë përbërëse e tenderit dhe sikurse OE që i marrin parasysh gjatë përgatitjes së Ofertës ashtu edhe AK gjatë vlerësimit është i obliguar t'i marr për bazë.

Pra, duke i marr për bazë sqarimet shtesë, grupi i OE "Aritech & Cimi@Electronicshpk," me ofertën e tyre NUK i kanë përmbushë kërkesat e AK të cilët kanë të bëjnë me mosdorëzimin e ofertën teknike dhe Broshurës ku është kërkuar të saktësohet modelin dhe karakteristikat tjera të mbajtësit të TV.

Prandaj e ftojme Ekspertin e lëndës t'i merr për bazë sqarimet shtesë nga AK dhe të Rivlerësoj edhe njëherë këtë pikë duke përmirësuar konstatimin e dhënë në Ekspertizë e parë dhe mostrajtimin e sak ne ekspertizën e dytë.

Sa për t'i rikujtuar edhe Ekspertit, në RUOPP, bazuara ne LPP Neni 28 decidivisht sanksionon dhe udhëzon saktësisht si të vepohet kur: MUNGON SPECIFIKACIONI TEKNIK PËR MALLRAT E OFERUARA DHE KATALOGU - Refuzo Tenderin pa kërkuar Informacion të mëtutjeshëm

PIKA 3. Përkundër faktit se Eksperti Shqyrtues pajtohet me pretendimin tonë dhe Ri konfirmon se OE Aritech & Cimi@Electronic shpk, "NUK ka dorëzuar fare Broshurën për Kevbord të TVsi dhe Nuk ka



specifikuara fare Modelin dhe specifikat e Keyboardit per TV" .

Duke u mbështet në RRUOPP, AK në këtë rast automatikisht do duhej ta Refuzonte ofertën e këtij OE si të papërgjegjshme.

Pra, edhe ne këtë rast RUOPP bazuar ne LPP Neni 28, decidivisht sanksionon:



MUNGON SPECIFIKACIONI TEKNIK PËR MALLRAT E OFERUARA DHE KATALOGU - Refuzo Tenderin pa kërkuar

Operatori ekonomik N.T.SH. ARTECH” dhe “N.T.P ERAMED, nuk ka përgjigje

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “Artech NTSH & Eramed NTP”, ku thuhet që AK ka vepruar kundërligjshëm duke shpallur njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin shpall fitues grupin e OE “ARITECH Sh.P.K; CIMI ELECTRONIC Sh.P.K dhe i ka eliminuar OE ankues “Artech NTSH & Eramed NTP” me arsyetimin se nuk kanë dorëzuar katalogun e njëjtë, me të cilin kanë ofertuar në dosjen e tenderit, Paneli Shqyrtues sqaron se tanimë ky pretendim ankimor është trajtuar dhe sipas nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si çështje e gjykuar “res judicata”.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues “Artech NTSH & Eramed NTP”, ku thuhet që AK gjithashtu ka vepruar kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 të LPP-së dhe nenin 49.25 dhe 49.26, pasi që ky i fundit ka dështuar të verifikoj kushtet formale të dokumenteve të tenderit pasi që ka pranuar dokumentin me nr. Referencë 1038ERQ ISO 9001:2015, Quality Management System në emër të CIMI



ELECTRONIC Sh.P.K si jo të rregullt dhe sipas verifikimit dhe vlerësimit tonë janë të falsifikuara, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe shkresave të dërguara nga palët e përfshira, gjen pretendimin si të pa bazuar sepse në letrën standarde për sqarim të dosjes së tenderit, dërguar OE të rekomanduar nga Autoriteti Kontraktues, OE i rekomanduar ka bashkëngjitur certifikatën e lartpërmendur duke vërtetuar kështu validitetin e një certifikate të tillë deri me 01.07.2021. Falsifikimi i një dokumenti të tillë mbi bazën e ndërhyrjeve teknike dhe nënshkrimit të personit të autorizuar nuk mund të evidentohet nga OSHP dhe nëse ka ndonjë dëshmi për falsifikim sikurse në pretendon OE ankues, i njëjti udhëzohet që ti drejtohet organeve kompetente. Certifikata e bashkëngjitur (shih më poshtë) është konform fushëveprimit të kërkuar dhe si e tillë është valide në afat kohor të përcaktuar.

Sa i përket pretendimin ankimor të OE ankues "BOTEK SHPK", ku thuhet që AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe UOPP-së pasi ka shpërblyer me kontratë një grup të OE të papërgjegjshëm teknikisht pasi që këta të fundit kanë ofertuar me pajisjen HP e cila nuk përmbushë kërkesën minimale të vendosur në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, gjegjësisht konfigurimin e kombinuar për Drives; SSD: 500 GB dhe HDD: 500 GB si dhe Lexuesi optik: DVD Drive pasi që në broshurën e dorëzuar nga vete OE i rekomanduar "Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor" konkretisht në faqen 2 të broshurës shkruan qartësisht "KUJDES" si në vijim: Note: Following configurations are supported: a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive, b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive, c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage.

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar kompjuter Brand Name - Mid Tower, është kërkuar që kjo pajisje të ofrohet me 3x komponentë - për 2X Storage and 1x Drives (SSD, HDD dhe Lexuesi Optik). Për këtë pozicion, Paneli Shqyrtues sqaron se OE "Aritech & Cimi@Electronic shpk" kanë ofertuar me pajisjen HP Desktop Pro 300 G3 e cila nuk ka mundësi nga vetë prodhuesi të ofrohet me 3x komponente për Storage and Drives siç është kërkuar në dosje të tenderit. Por kjo pajisje ka mundësi të ofrohet vetëm me 2 x komponente për Storage and Drives, si dhe konfigurimi mund të bëhet nga klienti sipas nevojës se cilat komponentë mund të kombinoj, Andaj, në bazë të broshurës së prodhuesit, ky model nuk mund të konfigurohet sipas kërkesës së AK-së. Pra pretendimet e OE ankues "BOTEK SHPK" janë të bazuara.

Sa i përket pretendimin ankimor të OE ankues "BOTEK SHPK" ku thuhet që në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë të datës 13.04.2020, është qartësuar nga ana e AK-së se operatorët ekonomik duhet të ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë specifikat teknike si tek pjesa e "Pretendimeve Ankimore" e këtij raporti, ku OE ankues thotë që për këtë pozicion, OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk, në ofertën e tyre nuk ka dorëzuar fare Broshurën për mbajtësin e TV, si dhe nuk ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e mbajtësit të TV. Paneli Shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim ankimor është

vendosur në vendimin paraprak për këtë çështje, andaj kjo pikë ankimore konsiderohet “res judicata”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka pasur parasysh kërkesat e dosjes së tenderit me rastin e vlerësimit të ofertave, si dhe nuk ka bërë vlerësimin në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që me rastin e ri-vlerësimit të zbatoj në përpikëri vendimet e Panelit Shqyrtues, të bëjë vlerësimin duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, si dhe në harmoni të plotë me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Geran Milenković

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK “KK Prishtinë”;
- 1x1 OE “Botek SHPK” – Prishtinë;
- 1x1 OE N.T.SH. ARTECH” dhe “N.T.P ERAMED;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.